



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0022
Data e Vendimit: 17.01.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “DWH-Kosova” SH.P.K kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja e paisjes për matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna Suharekë, U.D Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, z. Agim Sheqiri me datën: 17.01.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jashteafatshme, ankesa e OE “DWH-Kosova” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0022, e datës 07.01.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Blerja e paisjes për matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna Suharekë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 07.01.2025, ka pranuar ankesën e OE “DWH-Kosova” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e paisjes për

matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 14.10.2024, Komuna Suharekë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ndërkaq me datën 24.12.2024 është publikuar njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Operatori Ekonomik “DWH-Kosova” SH.P.K me datën 31.12.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 07.01.2025.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 24.12.2024 është publikuar vendimi i AK-së për anulim ndërsa kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 31.12.2024, që njëherësh ankesa është jashtë afatit ligjor prej 5 ditësh për dorëzim të KR kundër B58.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

c) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin e AK për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) për anulim të procedurës së prokurimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK është dita (0).

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 31.12.2024 është parashtruar jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika c) të Rregullores për Prokurimin Publik.

-Përfundim-

Neni 108/A paragrafi 3.3 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “...3.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim”.

Autoriteti kontraktues – Komuna e Suharekës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Blerja e paisjes për matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31

par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - DWH-KOSOVA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: